

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

---

### Mirësjellja / *el-Edeb* / الأَدَب

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu tha:

"وَالْحَافِظُونَ لِحُدُودِ اللَّهِ"

"... dhe ata që kujdesen për kufijtë e Allahut." (et-Teube, 112)

Sjellja e përshtatshme ka të bëjë me ruajtjen e kufijve të tepimit dhe të shkujdesjes duke njohur dëmin e shkeljes.<sup>1</sup> Kjo ka tri nivele:<sup>2</sup>

Niveli i parë:

- Ta pengosh frikën që të mos kalojë në dëshpërim.
- Ta kufizosh shpresën që të mos kalojë në siguri (indiferencë).
- Ta kontrollosh gëzimin që të mos kalojë në paturpësi.

Niveli i dytë:

- Të kalosh nga frika në zonën e ngushtësisë.
- Të ngrihesh nga shpresa në zonën e gjerësisë.
- Të lartësohesh nga gëzimi në zonën e të parët e hyjnores (*mushaahade*).<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Meqë ky është një koncept i hollë dhe jo gjithmonë një që rregullohet me prova të prera, këtu është me rëndësi të jesh i balancuar në sjelljen tënde me Allahun, me të Dërguarin e Tij, dhe me krijesat e Tij.

<sup>2</sup> Fokusi këtu është në mirësjelljen ndaj Allahut. Mjeshtrit e shtegut të pastrimit shpirtëror flasin po ashtu për mirësjellje me të Dërguarin e Tij dhe me krijesat e Tij. Sjellja e mirë me Allahun nis me përmbushjen e obligimeve, pastaj me sunetet e brendshme e të jashtme. Disa mirësjellje mund të mos mbështeten në prova të prera; ato arrihen nëpërmjet arsytimit logjik dhe intuitës së përshtatshme. Këto mirësjellje nganjëherë mund të jenë subjektive. Nëse këto nuk kërkohen nga Shpallja, nuk duhet të dënohen ose të zbatohen patjetër. Personi mund të vazhdojë butësisht me marrje dhe ushtrime të mirësjelljes, duke u dhënë përparësi mirësjelljeve që erdhën nga peygamberi r, pastaj nga sahabët, pastaj nga të tjerët menjëherë pas tyre, e kështu me radhë. Personi duhet të ndalojë, nëse disa sjellje dërrmojnë, ngadalësojnë përparimin, thajnë marrëdhëniet me Allahun ose pengojnë afrinë me Të.

Niveli i tretë:

- Njohja e mirësjelljes.<sup>4</sup>
- Asgjësimi i mirësjelljes nëpërmjet përpunimit nga i Vërteti.<sup>5</sup>
- Heqja qafesh e barrëve të mirësjelljes.<sup>6</sup>

---

<sup>3</sup> Në këtë nivel, personi ngrihet nga format në realitetin e tyre (formave). Realiteti i frikës sonë është ngushtimi (*kabd*) që Allahu na e bën, ndërsa realiteti i shpresës është zgjerimi (*bast*) që Ai na e bën. Hareja e dëgjueshmërisë tash errësohet nga respekti i thellë dhe mrekullimi që vjen nga të parët e hyjnore.

<sup>4</sup> Personi arrin përsosuri të mirësjelljes, njeh thelbin dhe kushtet e saj, dhe shikon nga lart në shkallët (stacionet) e mirësjelljes për t'i plotësuar me *ihsan*.

<sup>5</sup> Tash personi nuk i atribuon gjë vetvetes dhe as nuk sheh përpunimin që ia bën vetvetes; sheh vetëm përpunimin që ia bën Allahu.

<sup>6</sup> Kjo është atëherë kur uni shpërbëhet nëpërmjet *fanaa* (vetasgjësimit; nënshtrimit të vullnetit personal ndaj vullnetit të Allahut).